



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, më 26 mars, Trupi Gjykses miratoi kërkesën e Prokurorisë që një dëshmitar të jepte dëshmi përmes videolidhjes për arsye shëndetësore dhe sigurie. Vendimi i bë publik më 4 mars 2025.

Më 3 prill, Trupi Gjykses miratoi një kërkesë të Prokurorisë për të pranuar deklaratën e një dëshmitari vetëm në formë të shkruar dhe pa marrje në pyetje nga pala jothirrëse. Trupi Gjykses konstatoi se deklarata ishte relevante, konfirmohet në pjesë të madhe nga dëshmitarë të tjerë të cilët Mbrojtja pati mundësinë t'i merrte në pyetje dhe shërben për vërtetimin e aspekteve që nuk kanë të bëjnë me sjelljen e të akuzuarve.

Po atë ditë, Trupi Gjykses miratoi pjesërisht një kërkesë të Prokurorisë për të pranuar dëshminë me shkrim dhe provat materiale shoqëruese të shtatë dëshmitarëve. Trupi Gjykses miratoi kërkesën për ato prova që i konstatoi se janë relevante, autentike dhe të mbështetshme, vlera provuese e të cilave nuk zhbëhej prej efektit dëmtues të tyre. Trupi Gjykses hodhi poshtë kërkesën kur kishte dyshime për mbështetshmërinë e provave, ose e gjykoi atë të tejkaluar kur provat në fjalë ishin pranuar më parë.

Më 4 prill, Trupi Gjykses miratoi pjesërisht një kërkesë të Prokurorisë për të pranuar si prova disa dokumente të zonës operative të Nerodimes, që i konstatoi relevante, autentike, vlera provuese e të cilave nuk zhbëhej prej efektit dëmtues të tyre. Trupi Gjykses i nuk i pranoi si prova ato dokumente që, sipas mendimit të Trupit Gjykses, nuk kishin tregues të mjaftueshëm autenticiteti.

Në këtë çështje gjyqësore, është caktuar të mbahet një konferencë për ecurinë e çështjes më 23 prill, për të diskutuar hapat e ardhshëm në proces. Seanca është caktuar të fillojë në orën 10:00 paradite.

Më 7 prill u bë publik vendimi i Trupit Gjykses i datës 19 mars që i miratoi zotit Thaçi vizitë nën ruajtje për arsye humanitare, pasi babai i tij kishte ndërruar jetë. Trupi Gjykses konstatoi se, duke marrë parasysh lidhjet e ngushta familjare midis të akuzuarit dhe të ndjerit, fakti që babai i z. Thaçi ndërroi jetë, përbënte arsye humanitare bindëse që përligjte lirimin e përkohshëm të z. Thaçi për vizitë nën ruajtje. Megjithatë, sipas mendimit të Trupit Gjykses, vizita nën ruajtje gjatë varrimit dhe ceremonive përkujtimore publike, do të kishte shkaktuar shqetësime të konsiderueshme për sigurinë. Trupi Gjykses konstatoi se këto rreziqe do të zvogëloheshin sa duhet në qoftë se vizita kryhej pas varrimit.





Trupi Gjykses e mori vendimin në bazë të akuzave me të cilat përballet z. Thaçi, që përfshijnë vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, sipas të cilave ai ka nxjerrë informacion të fshehtë për të ndikuar në mënyrë të paligjshme në dëshmitë e dëshmitarëve. Trupi Gjykses shqyrtoi gjithashtu edhe nevojën për modifikimin e kushteve të paraburgimit, sepse duket se z. Thaçi u ka dhënë vizitorëve jo të privilegjuar informacion të marrë gjatë dëshmisë së dëshmitarëve të mbrojtur. Trupi Gjykses kujtoi gjithashtu se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të pengojë ecurinë e procesit dhe/ose të kryejë vepra penale të tjera.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit për ndikim ndaj dëshmitarëve, më 3 prill, Paneli i Apelit hodhi poshtë pikat 1, 2 dhe 3 të apelit të Prokurorisë kundër vendimit të Gjykatës së Procedurës Paraprake mbi konfirmimin e Aktakuzës. Paneli i Apelit, me vendim të shumicës, miratoi pikën 4 të apelit, duke konstatuar se në këtë rast zbatohet forma e tretë e nxitjes në nenin 32(3) të Kodit Penal të Kosovës. Për këtë arsye, kjo pikë iu kthye Gjykatës së Procedurës Paraprake për të vlerësuar nëse provat mbështesin konfirmimin e një akuze shtesë, që fillimisht u hodh poshtë nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake.

Më 7 dhe 8 prill 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Bashkim Smakajt, me konstatimin se për katër të akuzuarit ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se mund të arratisen, të pengojnë ecurinë e procesit ose të kryejnë vepra penale të tjera. Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi më tej se këto rreziqe mund të zvogëlohen vetëm duke vazhduar paraburgimin e tyre.

Më 7 prill, Gjykatësja e Procedurës Paraprake hodhi poshtë një kërkesë të Mbrojtjes së z. Smakaj për të pushuar procesin kundër z. Smakaj, bazuar në një intervistë të dëshmitarit 2, që u nxor për Mbrojtjen dhe Gjykatësën e Procedurës Paraprake vetëm pasi ishte konfirmuar Aktakuza. Mbrojtja ishte e mendimit se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk do ta kishte konfirmuar Aktakuzën po të kishte qenë në dijeni të kësaj interviste. Megjithatë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se vendimi për konfirmim në lidhje me përgjegjësinë penale të z. Smakaj u bazua në disa faktorë dhe, rrjedhimisht, ajo nuk u bind se dijenia për intervistën do ta kishte ndryshuar vendimin e saj. Bazuar në këtë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arriti në përfundimin se intervista me dëshmitarin 2 është aspekt që do të diskutohet gjatë gjykitimit.

Në çështjen gjyqësore të Salih Mustafës, më 3 prill 2025, u bë publik një vendim i Gjykatës të Vetëm i shtatorit 2024 në lidhje me pagesën e zhdëmtimeve. Në vendim, Gjykatësi i Vetëm mbajti parasysh dëshirën e një viktime pjesëmarrëse në proces për të mos marrë pagesën për zhdëmtim. Duke pasur parasysh se viktimat në këtë çështje gjyqësore nuk kanë marrë ende pagesën e plotë për zhdëmtim, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi Administratoren që shumën e refuzuar të ndajë midis viktimave pjesëmarrëse të tjera. Megjithatë, ai theksoi se pagesat për zhdëmtimin e çdo viktime përgjithësisht nuk mund të jenë më të larta se shumata e caktuar për secilën viktimitë, sikurse përcaktohet në urdhrin për zhdëmtim.

